



## Forum Informativ

### “Kuptimi i procesit të integrimit europian të vendit”

#### Ftesë

E premte, 3 shkurt 2012, ora 11:00 – 13:00  
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) ka kënaqësinë t’ju ftojë në forumin informativ “Kuptimi i procesit të integrimit europian të vendit” i cili do të organizohet:

Të premten, 3 shkurt 2012, ora 11:00 – 13:00, në Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

E ftuar nderi në këtë aktivitet do të jetë Shkëlqësinë e saj Znj. Fiona McIlwham, Ambasadore e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri.

Ndonëse gjerësisht pranohet se integrimi në BE është një prioritet kombëtar, opinionin publik ende mbetet i painformuar. Kjo mund të vërehet lehtë nga mbizotërimi në opinionin publik të idesë se aspektet politike të integrimit janë çështja më e rëndësishme e tij. Ndërsa është e vërtetë se aspektet politike janë një hap i parë i rëndësishëm në rrugën e integrimit, pak vëmendje i është dhënë transformimit social e ekonomik që sjell ky proces, për vendin e shtresa të ndryshme të shoqërisë. Kjo situatë shqetësuese mund të shpjegohet jo vetëm nga kompleksiteti i procesit, por edhe nga fakti që shpesh informacioni dhe analiza mbi BE-në nuk ofrohet nga ekspertët, por jepet kryesisht nga politika. Një tjetër element është dhe qarkullimi më së shumti i informacioneve të përgjithshme që nuk shërbejnë si lëndë e parë për të reflektuar dhe debatuar mbi procesin e integrimit të Shqipërisë.

Në mënyrë që të stimulojë një debat më të informuar dhe pa klishe për integrimin në BE, EMA në bashkëpunim me komunitetin akademik po realizon një seri analizash dhe aktivitete informuese me grupet e interesuar, pjesë e të cilave është dhe Forumi i organizuar me Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

Ky aktivitet mbahet në kuadër të projektit “Shtjellimi i Procesit të Integrimit Europian”, mbështetur nga Ambasada Britanike në Shqipëri.



### Programi:

- 11:00 – 11:15 Hapja e takimit  
Z. Gjergji Mero, Rektor i Universitetit të Korçës “Fan S. Noli”
- 11:15 – 11:35 Nevoja për një debat të gjerë publik mbi procesin e Integrimit European– Shteti i së Drejtës si një nga kushtet kryesore për të ardhmen europiane të Shqipërinë  
SH. S. Znj. Fiona McIlwham, Ambasadore e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri.
- 11:35 – 11:50 Raporti i Progresit të Komisionit European për Shqipërinë 2011 – Si duhet ta lexojmë  
Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri
- 11:50 – 12:10 Drejt një administrate publike të standardeve europiane – Një vështrim mbi reformimin e administratës publike shqiptare  
Znj. Blerta Hoxha, Hulumtuese, Lëvizja Europiane në Shqipëri
- 12:10 – 12:30 Diskutim i hapur/ Pyetje përgjigje
- 12:30 – 12:45 Shpërndarja e publikimeve tek studentët dhe në Qendrën e Informimit mbi BE-në të pranë Universitetit “Fan S. Noli”
- 12:45 Koktej

\*Gjatë leksionit do të sigurohet përkthimi në gjuhën shqipe dhe angleze.